

KALENDARI I PËRBASHKËT KULTUROR VJETOR

MIDIS

MINISTRISË SË KULTURËS
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Tiranë, 2021

Referuar “Deklaratës së Përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës”, nënshkruar në Prizren më datë 11 janar 2014, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës, bien dakord për përfshirjen e aktiviteteve të mëposhtme në Kalendarin e Përbashkët Vjetor për vitin 2022.

KREU I AKTIVITETE TË NATYRËS SË PËRGJITHSHME

Bashkërendimi për çështjen e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në organizatat kulturore ndërkombëtare.

KREU II MENAXHIMI KULTUROR

Të dyja vendet do të angazhohen të krijojnë kushtet dhe mundësitë për shqyrtimin dhe hartimin e një programi të përbashkët për Menaxhimin Kulturor dhe shkëmbimin e artistëve.

KREU III LIBRI, LEXIMI DHE BIBLIOTEKAT

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

Në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë gjatë vitit 2022, do të realizojë veprimtaritë si vijon:

- a. Konferencë Kombëtare e Bibliotekonomisë
- b. Konferencë shkencore dhe Ekspositë për Branko Merxhanin, në kuadër të 40-Vjetorit të ndarjes ngajeta të Branko Merxhanit
- c. Konferencë shkencore dhe Ekspositë për Pjetër Budin, në kuadër të 400-Vjetori të vdekjes së autorit
- d. Konferencë shkencore dhe Ekspositë për Krist Malokin, në kuadër 50 vjetorit të ndarjes ngajeta të Krist Malokit

Palët do të organizojnë veprimtaritë sipas rendit dhe reciprokisht, secili institucion e organizon veprimitarinë në vendin ku mbahet veprimtaria, në Shqipëri – BKSh, në Kosovë - BKK. Programi i veprimitarisë propozohet nga një komitet i përbashkët bashkërendimi, i caktuar nga Drejtoritë e të dyja institacioneve dhe miratohen prej këtyre Drejtorive.

KREU IV FILMI

Qendra Kombëtare Kinematografike

1. Pjesëmarrje e përbashkët në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Berlin, ku Qendra Kinematografike e Kosovës bashkë me Qendrën Kombëtare e Kinematografisë kanë një stendë të përbashkët në Marketin e Filmit në Berlin ku promovohet kinematografia e të dyja vendeve
2. Pjesëmarrje e përbashkët në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Cannes ku Qendra Kinematografike e Kosovës bashkë me Qendrën Kombëtare e Kinematografisë kanë një stendë të përbashkët në Marche du Film, Cannes ku promovohet kinematografia e të dyja vendeve
3. Bashkëpunimi me Festivalet e tjera ndërkombëtare të Filmit të organzuara në Shqipëri dhe të finançuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë

KREU V TEATRI , ANSAMBLET DHE BALETI

1. Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor

- a. Realizimi i shfaqjes së titulluar "Carmina Burana" të kompozitorit Carl Orff në Prishtinë dhe Tiranë
- b. Realizimi i një shfaqje baleti të titulluar "Monger" në Teatrin Kombëtar të Kosovës
- c. Realizimi i një shfaqje të përbashkët në gjinin e këngës popullore midis Ansamblit Popullor dhe Ansamblit të Këngëve dhe Valleve "Shota", të titulluar "Gjerdani i Artë" nga artistet Fitneta Rexha & Nexhmije Pagarusha

2. Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"

- a. Realizimi i festivalit të regjisoreve dhe dramaturgëve të rindjeve
- b. Realizimi i një shfaqje të titulluar "Hevay stone"- një bashkëproduksion i TKEKS, Teatrit ODA dhe "Qendra për fëmijët dhe të rinjtë", me fokus emigrimin e të rinjve
- c. Pjesëmarrja e TKEKS në festivalin "Femart" në Qershor 2022
- d. Pjesëmarrja e Artpolis në festivalin që do të organizojë TKEKS në Prill 2022, të titulluar "Tirana contemporary theater fair"

3. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

- a. Konkurse të ndryshme për fëmijë, shfaqje për fëmijët e diasporës shqiptare.

- b. Workshope për stafin e Teatrit të Kukullave mbi teknikat e reja të kukullave, skenografive dhe konceptet regjisoriale bashkëkohore
- c. Zhvillimi i një tour-i shëtitës në Kosovë dhe Shqipëri me shfaqje teatrale me kukulla
- d. Krijimi i një foni të dedikuar për lëvizjen e artistëve për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete artistike/shfaqje

4. Baleti Kombëtar i Kosovës

- a. "La Stravaganza" (TKOB) & "Tanzminiaturen" (BKK), 29 Qershori 2022
- b. "Annocation" (TKOB) & "Tangata" (BKK), 30 Qershori 2022

KREU VI TRASHËGIMI KULTURORE

1. Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë

- a. Eksposita "Miss Mary Edith Durham", për periudhën: maj – qershori 2022, në Muzeun Kombëtar të Kosovës.
- b. Ekspozitë fotografike dhe promovimi i katalogut "Thesare të Muzeut Historik Kombëtar" në Muzeun Kombëtar të Kosovës për periudhën janar – mars 2022.
- c. Botimin e një katalogu të përbashkët në fushën e arkeologjisë midis Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeut Kombëtar të Kosovës, kryesisht për fushën e prehistorisë ku kultura materiale është e njëjtë, të titulluar "Arkeologjia e Shqipërisë dhe e Kosovës".
- d. Realizmi i një workshop-i përfshirjen e komunitetit në Muzeun Historik Kombëtar dhe Muzeun Kombëtar të Kosovës, me titull "Muzeu i komunitetit-Programet Edukative në Muzeun Historik Kombëtar dhe Muzeun Kombëtar të Kosovës".

2. DRTK Berat

- a. Realizimi i vizitave të përbashkëta në kalanë e Beratit, Qendrës Mesjetare në datë 8 Korrik, në kuadër të përvjetorit të hyrjes së Beratit në UNESCO.
- b. Realizimi i ekspositave fotografike dhe pikturave të përbashkëta në datë 29 shtator në kuadër të Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore.

3. DRTK Vlorë

- a. "Trashëgimia e qarkut Vlorë në Prizren", panair zezesh nga qarku Vlorë, si dhe një aktivitet kulturor/koncert me artistë të muzikës tradicionale/popullore nga Vlora dhe Prizreni. Ky aktivitet do të zhviliohet në bashkëpunim me Qendrën Rajonale për Trashëgiminë Kulturore - Prizren.

b. "Trashëgimia e qarkut Vlorë në Mitrovicë", Mitrovicë/Malishevë/ Muzeun e Lidhjes së Prizrenit;

4. Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike

Realizimi i një shfaqje të përbashkët të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore Shqipëri dhe Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" Kosovë dhe të shfaqet në të dy vendet.

5. Parku Kombëtar Butrint

Realizimi i aktivitetave, konferencave, ekspositave të përbashkëta gjatë ditëve 7-14 dhjetor 2022 (që korrespondon me ditët kur është mbledhur sesioni i 16-të WHC 7-14 dhjetor 1992 për regjistrimin e Butrintit në listën e pasurive botërore të UNESCO).

6. Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore -Prizren

Eksposita "Personalitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" e cila do të mbahet me 12 Qershor në Vlorë me rastin e shënimit të 144 vjetorit të themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Eksposita "Tipologjia e objekteve kulturore- ekspositë me fotografi/skica /vizatime dhe përshkrime të objekteve kulturore në Prizren" e cila do të mbahet në Berat apo Gjirokastër.

Ekspositë me eksponate arkeologjike dhe etnologjike të Regionit të Prizrenit, e cila do të mbahet në Korçë.

7. Qenda Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Mitrovicë

Eksposite me fotografi, "Isa Boletini dhe Trashegimtarit neper Kohë (1908 - 1960) " Planifikohet te mbahet ne Vlorë

Eksposite me artefakte arkeologjike dhe eksponate etnologjike Regioni Mitrovicë. Planifikohet te mbahet ne Korçë dhe Vlorë

8. Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjilan

Eksposite me fotografi nga Trashegemia Kulturore - Rajoni i Gjilanit dhe Korçes, me theks trashegemia arkitekturore me titull "Eksposite me fotografi " – Vlera te Trashëgimisë – udhëtim nëpër kohë si dhe Botimi i katalogut të përbashkët me fotografi - Eksposite me fotografi " Vlera te Trashëgimisë – udhëtim nëpër kohë"

Realizimi i ekspozitave fotografike ne kuader te diteve te Trashegimise Kulturore Evropiane ne muajin shtator.

KREU VII

MUZEU

Organizim i Ekspozitës "Trashëgimia Kulturore dhejeta ndër breza" e Muzeut Kombëtar të Kosovës, në ambjentet e Muzeun Historik Kombëtar, Tiranë.

Organizim i Ekspozitës "Trashëgimia Arkeologjike Adriatiko-Meditariane në Kosovë" e Muzetit Kombëtar të Kosovës, në ambjentet e Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë

Programet edukative në Muzeun Kombëtar të Kosovës "Muzeu në kuti", "ABC për trashëgimine kulturore" që mund të përfshihen në planifikimet e përbashkëta me Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë

"Veprimtaria Atdhetare e Heroit të Kombit Sali Çekaj" në ambjentet e Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë

KREU IX

GALERIA E MINISTRISË SË KULTURËS

Organizim i Ekspozitës "Bashkndarje", ekspozitë e kuruar nga Zef Paci,

KREU IX

CREATIVE EUROPE

Bashkëpunim midis palëve në kuadër të "Creative Europe Desk".

Organizimi i Sesioneve të Informimit të Përbashkët.

Shkëmbim i eksperiençave më të mira midis dy *Desqeve* të nën-programit "Kultura".

KREU X

E DREJTA E AUTORIT

Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Kosovës kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi në vitin 2017. Në zbatim të këtij memorandumi palët do të vazhdojnë realizimin e aktivitetave të parapara.

KREU XI
KOMUNIKIMI MES PALËVE

Palët do të mbajën komunikim të vazhdueshmë për çdo aktivitet të propozuar, duke emëruar persona që do të marrin pjesë në shkëmbime dhe do të njoftojë palën pritëse për këto emërime tre (3) muaj para datës së fillimit të propozuar.

Pala dërguese do ti sigurojë Palës pritëse të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kualifikimet akademike dhe profesionale të personave të emëruar, si dhe programin e propozuar të punës dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Pala pritëse.

KREU XII
FINANCIMI I AKTIVITETEVE

Kostot financiare të aktiviteteve të parashikuara, do të mbulohen nga institucioni organizator ose të bashkërenduara midis palëve, brenda fondeve të tyre të miratuara për vitin buxhetor 2022.


Nënshkruar në ELBASAN, më 26 / 11 / 2021.

**PËR MINISTRINË E KULTURËS
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**



ELVA MARGARITI
MINISTËR

**PËR MINISTRINË E KULTURËS,
RINISË DHE SPORTIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**



HAJRULLA ÇEKU
MINISTËR